

fakte mbi
#AktivitetinFilantropik2018
Shqipëria

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
Tiranë, Shqipëri 2018

Prej vitit 2011 Partnerët Shqipëri punon për promovimin e filantropisë në vend . Duke marrë në konsideratë informacionet e pakta në këtë fushë, **Partnerët Shqipëri** kreu studimet:

- **“Sipërmarrja dhe Filantropia”** për të krijuar një kuptim më të qartë të shkallës dhe natyrës së kauzave shoqërore të cilat mbështeten prej komunitetit të biznesit në Shqipëri,
- **“Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri”**, që trajton këtë veprimtari, figurat kryesore dhe aktivitetin e tyre filantropik brenda dhe jashtë vendit, nga shekulli i XIX e deri në ditët e sotme,
- **“Aktiviteti Filantropik i Ndërmarrjeve në Shqipëri, Studimi i Dytë, 2016”** i cili synon të vlerësojë nivelin dhe karakteristikat e aktivitetit filantropik që kryen sektori i biznesit në Shqipëri, tiparet e zhvillimit të këtij aktiviteti gjatë periudhës 2011-2016, si dhe tendencat për të ardhmen.

Për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e kësaj traditë të hershme dhe me vlera, Partnerët Shqipëri organizon tashmë prej gjashtë vitesh ceremoninë **“Çmimi i Filantropisë”**, duke shprehur mirënjohjen dhe falenderimin për individët, familjet dhe bizneset që kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës në vend. Vlerësimi dhe stimulimi i një aktiviteti të tillë mbetet i rëndësishëm për dimensionin human dhe ekonomik që ai mbart.

Spektori i biznesit luan, midis aktorëve të tjerë, një rol të rëndësishëm në mbështetjen e iniciativave që adresojnë probleme të mprehta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Në këtë funksion, Partnerët Shqipëri ka vendosur një partneritet të ngushtë me sektorin e biznesit në mbështetje të bizneseve të reja sociale në fushën e industrisë së gjelbërt.

Prej vitit 2013 Partnerët Shqipëri organizon konkursin vjetor **“Ide të Gjelbërta”** si pjesë e të cilit mbështeten sipërmarrje që promovojnë përfshirjen sociale, integrimin dhe punësimin, nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve lokale e ringjalljes së traditave, duke ndjekur një përqasje miqësore ndaj mjedisit. Risia qëndron në bashkëpunimin dhe krijimin e një fondi investimi të përbashkët të krijuar nga dhurime të bizneseve dhe institucioneve filantropike private, lokale dhe ndërkombëtare në mbështetje të bizneseve të reja të gjelbërta. Automatikisht, idetë fituese konkurrojnë në nivel Ballkanik në konkursin **“Filantropia për Ide të Gjelbërta”** organizuar nga Rockefeller Brothers Fund.

Metodologjia

Ky raport pasqyron aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2018 i sjellë në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe **raportimin e rregullt mujor**.

Metodologjia e përdorur për realizimin e tij u bazua në të dhëna të mbledhura nga hulumtimi ditor i mediave, përfshi ato sociale si dhe nga institucionet publike dhe jo-publike gjatë periudhës janar - dhjetor 2018.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.

Fjalor

OJF - Organizata Jofitimprurëse



Publik i Gjerë - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës



Ndihmë Ekonomike - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë me vështirësi ekonomike apo gjatë fatkeqësive natyrore

Mix – Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet.

Dhurime Sezonale – Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit





Mijë Lekë


Vlera sipas Dhuruesve në Lekë



Përsa i përket vlerës së dhurimit **Individët** zënë vendin e parë me një vlerë prej 66,085,551 Lekë, të ndjekur nga **OJF-të** me 12,519,088 Lekë, dhe **sektori i Biznesit** me 11,954,147 Lekë. Saktësisht 11,425,900 Lekë nga Korporatat dhe 528,874 Lekë nga Ndërmarrje e Vogla dhe të Mesme.

nr.


Numri i Dhuruesve*



Gjatë 2018 janë konstatuar 92 **Individë**, të cilët kanë dhuruar 38% të vlerës totale të dhurimit, dhe 53 **Korporata**, të cilat kanë dhuruar 22% të vlerës totale.

*Për hatër të analizës llogariten vetëm një herë pavarësisht numrit të dhurimeve të kryera gjatë periudhës së monitoruar.

Fushat e Dhurimit



Në lidhje me fushat e dhurimit, situata është e njëjtë me atë të një viti më parë. Tre fushat kryesore vazhdojnë të jenë **Mbështetja e Grupeve të Margjinalizuara** me 34% (110) të rasteve të dhurimit, ndjekur nga **Dhurimet Sezonale** me 24% (78), dhe **Zbutja e Varfërisë** me 12% (40) të rasteve të dhurimit.

Përfituesit



- Fëmijët & Të Rinjtë (60.67%)
- Publik i Gjerë (24.70%)
- Të Rritur (14.33%)
- Tjetër (0.30%)

Për 2018 përfituesit kryesor janë **Fëmijët dhe të Rinjtë** me 60,67% të totalit të rsteve të dhurimit, ndjekur nga **Publiku i Gjerë** me 24,7% dhe **Të Rriturit** me 14,33%.


FËMIJË+TË RINJTË

- (88) Pa Përkujdesje Prindërore
- (50) Paaftësi Intelektuale
- (27) Zonë Specifike
- (10) Prob. Shëndetit Fizik
- (9) Në Përgjithësi
- (8) Komunitetet Minoritare
- (4) Të Talentuar
- (3) Vështirësi Ekonomike



TË RRITUR

- (34) Të Moshuar
- (1) Me Paaftësi Fizike
- (4) Probleme të Shëndetit..
- (1) G&F-Viktima të Dhunës
- (6) G&F-Viktima të Trafik..
- (1) G-me Foshnje




PUBLIK I GJERË

- (40) Me Vështirësi Ekonomike
- (18) Nga Një Zonë Specifike
- (17) Publik i Gjerë
- (1) Komunitetet Minoritare
- (1) Që Jetojnë Jashtë Vëndit




Kanalet e Dhurimit

Institucionet Sociale vazhdojnë të mbeten një nga kanalet kryesore të dhurimit, 150 (45,7%) e rasteve janë kanalizuar përmes tyre, ndërsa 83 (25,3%) e rasteve të dhurimit kanë shkuar **direkt tek përfituesit**, dhe 72 (22%) raste janë kanalizuar përmes **OJF-ve**.



Shpërndarja Gjeografike e Dhurimeve


Kryeqyteti vazhdon të jetë baza e dhuruesve dhe përfituesve, dhe kjo sigurisht lidhet me numrin e popullsisë, bizneseve dhe medias.



Gjithashtu dhuruesit nga Diaspora janë gjithnjë prezent kur bëhet fjalë për mbështetjen e fushatave apo rasteve që kanë nevojë për ndihmë urgjente në Shqipëri. Një shembull është rasti i fushatës së ngritur për 6 vajzat jetime nga Kukësi, të cilat kishin nevojë për një shtëpi.

Fushata u transmetua në të gjithë Shqipërinë, në Kosovë, dhe u përhap në të gjitha mediat sociale. Nëpërmjet kësaj fushate u arrit të grumbullohej më shumë se 40,000 Euro, dhe dhuruesit ishin kryesisht shqiptarë nga SHBA.

Format e Dhurimit



Pjesa më e madhe e donatorëve dëshirojnë të shohin impaktin direkt tek përfituesi, ndaj preferojnë dhurimin e drejtpërdrejtë. Për 2018, numri i dhurimeve të drejtpërdrejta është 178 (54,1%), ndjekur nga dhurime të kryera përmes Eventeve me 83 (25, 23%) dhe 68 (20,67%) raste nëpërmjet Thirrjeve për dhurim/Fushatave.

EVENTE+FUSHATA GJATË 2018

Zhvillohet i Pari Event "Rrathë Dhurues" në Shqipëri

Partnerët Shqipëri, organizoi mbrëmjen e 4 dhjetorit ankandin e parë të dhurimit "LIVE" – "**Rrathë Dhurues**". Ky event mbledhi së bashku përfaqësues të lartë të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, institucioneve diplomatike, shoqërisë civile, medias, artit etj., të cilët ofruan mbështetje financiare dhe materiale për tre iniciativa:

Një kopsht për fëmijët e fshatit Blliçe – Peshkopi, e ndërmarrë nga Vizion OJF.

Adopto një terapi– Tiranë, një iniciativë e Fondacionit Down Syndrome Albania.

Edukimi dhe integrimi i fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian përmes sportit – Shkodër, nga Shoqata për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian.

Shuma totale e mbledhur prej 1,681,874 Lekë kaloi objektivin e vendosur, duke konfirmuar edhe njëherë ndjeshmërinë qytetare ndaj grupeve në nevojë.

Falë ndjeshmërisë dhe vëmendjes së lartë mediatike që mori eventi, iniciativat vijojnë të sigurojnë mbështetje financiare edhe nga individë që nuk mundën të bëhen pjesë e tij.

AlbChrome në bashkëpunim me programin "Planning & Local Governance Project" të mbështetur nga qeveria Amerikane nëpërmjet USAID, duke filluar nga viti 2018 dhe në vijim, do të mbështes shkollën e mesme "Ali Myftiu" në Elbasan. Përfituesit e parë të këtij programi ishin 27 të rinj të vitit të tretë të degës mekanike, të cilët ndoqën profilin e fonderi-metalurgjisë pranë kësaj shkolle. Nxënësit ishin të pajisur me uniforma të posaçme dhe profesorë të dedikuar dhe për nxënësit që vinin nga rrethinat e Elbasanit, transporti rrugor u mbulua nga vetë AlbChrome. Programi përfshiu një ndërthurje të anës teorike me atë praktike, në të cilën nxënësit dy herë në javë ndoqën praktikën pranë fonderisë së metalurgjisë në Elbasan, ku edhe shkrihet kromi që vjen nga Bulqiza. Ky program ka si qëllim që nxënësit e trajnuar më pas të kenë një punësim të sigurt në Elbasan, pikërisht në fonderinë e menaxhuar nga AlbChrome.

Prej 2 vitesh Telekom Albania ofron programin e shëndetësor falas, **ONE LIFE**. Ky është një program unik nga të cilët klientët e Telekom përfitojnë një seri shërbimesh shëndetësore dhe check-up falas, ulje në trajtime dhe kirurgji estetike si edhe shërbime dentare falas. Spitalet si Hygeia, Spiatli Amerikan, Doctors' Hospital, etj i janë bashkuar kësaj nisme, në të cilën janë regjistruar më shumë se 330,000 klientë, me vlerë shërbimi mbi 15,000 lekë.

Mësoni më shumë këtu: www.telekom.com.al/onelife

Project CURE në bashkëpunim me Spitalin e Kavajës, me koordinatore Dr. Ina Farka ngritën fushatën "**Mbështet Spitalet në Shqipëri**" në një prej platformave crowdfunding me fokus bamirësinë ***4agoodcause***. Qëllimi i kësaj fushate ishte grumbullimi i 24,000 USD për të dërguar në Shqipëri një kontenier me ndihma humanitare dhe pajisje mjeksore. Falë dhurimeve nga shqiptarë të SHBA-ve dhe koordinimit të Dr. Farka, kontenieri mbërriti në Spitalin e Kavajës, ku u shpërndanë ndihmat dhe pajisjet mjeksore me një vlerë prej 500,000 USD. Kjo iniciativë nuk do të mbetet këtu, spitali i radhës është ai i Dibrës.



Fushata për të ndihmuar spiatlin e Dibrës ka nisur, për të gjithë ata që dëshirojnë të dhurojnë ky është link-u i fushatës: https://4agc.com/fundraiser_pages/a560c7de-0777-46d7-a974-0d473709b6da#.XOe1FdIzblU

Krahasimi midis vitit
2017 - 2018

Në 2017 numri i dhurimeve ishte 347, ndërsa në 2018 janë kryer 328 dhurime.

Në lidhje me vlerën e dhurimeve, në 2018 vlera totale e dhurimit është 95,182,953 Lekë, që është 48% më shumë se në vitin 2017.


Numri Total i Dhurimeve



Vlera Totale e Dhurimeve

Gjatë këtyre dy viteve dhuruesit janë të njëjtë, Individët mbetën dhuruesit kryesor, ndjekur nga biznesi dhe OJF-të.

Kjo vlen edhe për fushat e dhurimit, sikurse tregohet në grafik, ato mbeten njësoj.





Rruga Sulejman Delvina, N. 18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,
Kutia Postare (PO Box) 2418/1
Tel./Fax 04 2254881
Email: partners@partnersalbania.org
<http://ëëë.partnersalbania.org>